Në inspektime të programuar+ tematik(riinspektim, puna në turne, autorizime, këshillim, Ipard)	6070	958	16%
Në inspektime për aksident në punë	207	159	76%
Në inspektime për shkak ankese	627	219	36.1%
Inspektime rastësore	135	104	77%

Numri i subjekteve të gjobitura sipas rajoneve dhe sektorëve për vitin 2021


Drejtoria Rajonale/Spektori i Inspektimit	Nr inspektimeve	Subjekte me gjoba	Vlerë (000)
Drejtoria Rajonale Tiranë-Rajoni I	3446	47	9910
Spektori i Inspektimit Tiranë	2985	41	9120
Spektori i Inspektimit Durrës	461	6	790
Drejtoria Rajonale Vlorë-Rajoni II	1190	8	1850
Spektori i Inspektimit, Berat	255	3	700
Spektori i Inspektimit, Fier	560	1	900
Spektori i Inspektimit, Vlorë	375	4	250
Drejtoria Rajonale Dibër-Rajoni III	422	10	2700
Spektori i Inspektimit, Dibër	237	7	1800
Spektori i Inspektimit, Kukës	185	3	900
Drejtoria Rajonale Korçë-Rajoni IV	888	15	1370
Spektori i Inspektimit, Korçë	506	7	450
Spektori i Inspektimit, Elbasan	382	8	920
Drejtoria Rajonale Shkodër-Rajoni V	571	19	4690
Spektori i Inspektimit, Shkodër	350	7	1920
Spektori i Inspektimit, Lezhë	221	12	2770
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë-Rajoni VI	522	3	1910
Spektori i Inspektimit, Gjirokastrë	353	1	1210
Spektori i Inspektimit Sarandë	169	2	700
Total	7039	102	22430

Gjatë periudhës vitit 2021 janë vendosur 102 gjoba për shkelje të dispozitave ligjore. Nga këto :

- 58 gjoba gjatë inspektimeve për aksidente në punë
- 20 gjoba gjatë inspektimeve për ankese, denoncime nga të tretët
- 21 gjoba në inspektime të programuara
- 3 gjoba në inspektime rastësore

Ekzekutime të gjobave sipas Rajoneve

Më poshtë paraqitja grafike e ekzekutimit të gjobave të vitit 2021 që janë në fuqi, ekzekutuar në periudhën janar-dhjetor 2021, sipas secilit Rajon të ISHPSHSH-së:



Theksojmë se për cdo rast sanksioni me gjobë kanë filluar procedurat e ekzekutimit.


Me qëllim vënien në ekzekutim të dënimeve administrative gjobë, janë përgatitur vërtetime për Drejtoritë Rajonale lidhur me ankimimin ose jo të subjekteve të sanksionuara nga inspektorët e punës dhe janë dërguar vendimet e KAGJ-së, me qëllim paraqitjen e tyre për nxjerrjen e titullit ekzekutiv për vjeljen e gjobave, apo njoftimin e subjektit për të bërë ekzekutim vullnetar duke i vënë në dispozicion mandatet e arkëtimit dhe kërkesën për likuidim vullnetar.

Ky proces mbi ndjekien e ekzekutimit të gjobave është vënë në fokus të Drejtorive Rajonale, ku edhe janë udhëzuar mbi mënyrën e ndjekies së tyre dhe i janë dërguar formate tip me qëllim unifikimin e kësaj praktike. (info më e detajuar paraqitet më poshtë).

Analizë e të dhënave mbi inspektimit me gjobë.

- Duke vënë në vëmendje të shtuar detyrim për ndjekin e ekzekutimit të gjobave, si faza e fundit e procedurës civile dhe administrative, e cila ndikon direkt në të drejtat e palëve dhe se zbatimi i tyre është realizimi përfundimtar i të drejtave ligjore, është ndjekur me përparësi ekzekutimi i gjobave. Gjatë vitit 2021 janë ekzekutuar 54 % e gjobave që kanë hyrë në fuqi në kuptim të Kodit të Procedurës Administrative. Gjatë vitit 2020 janë ekzekutuar 44% të gjobave të vëna.

Gjopa te likujduara



Nga sa më lart kemi një kurbë në rritje të gjobave të ekzekutuara brenda vitit në të cilin janë vënë.

- Janë në proces ekzekutimi 100% e gjobave të vendosura dhe që janë në fuqi.
- Në 100 % të rasteve subjektet kanë marrë dijeni për vendimin përfundimtar të inspektimit.
- 66 % e rasteve subjektet kanë nënshkruar aktet e inspektimit, dmth kanë marrë njoftim nëpërmjet dorëzimit personal.
- 2 % të rasteve është përdorur njoftimi publik për njoftimin e akteve të Inspektimit, pasi njoftimi me format e tjera nuk ishte i mundur të kryhej dhe dërgesa nuk i arriti marrësit.
- 96% e gjobave të ekzekutuara janë likujduar vullnetarisht nga subjektet.
- Janë arkëtuar 53 gjopa të viteve të shkuara.

Dispozita ligjore të shkeluara për të cilat është vendosur gjobë

- Sipas tipologjisë së shkeljes, janë konstatuar :
 - 47 shkelje të dispozitave të Ligjit 7961, datë 1995 “ Kodi i Punes “, i ndryshuar
 - 35 shkelje të dispozitave të Ligjit 10237 “ Per sigurine dhe shendetin ne pune “,
 - 23 shkelje të dispozitave të Ligjit 9634 “ Per Inspektimin ne pune “,
 - 5 shkelje të VKM nr. 312 “Për miratimin e Rregullores “Për sigurinë në kantier
 - 1 shkelje të dispozitave të Ligjit 9136 “ Per kontributet e sigurimet shoqerore....”
 - 1 shkelje të VKM nr.562 “Per kontrolle testime periodike per pajisjet e punes...”
 - 2 shkelje të VKM nr.564, date 03.07.2013 “Per miratimin e Rregullores “ Per kerkesat minimale te sigurise dhe shendetit ne vendin e punes”.
 - 1 shkelje të dispozitave të VKM nr.563

Vendime të Komisionit të Ankimit të Gjobave:

Gjatë vitit 2021 janë ankimuar dhe shqyrtuar 39 raste në Komisionin e Ankimit të Gjobave, për të cilat në:

- 3 raste është marrë vendimi për ulje të vlerës (ndryshuar)
- 3 raste ndryshuar vendimi nga gjobë në paralajmërim
- 3 raste është shfuqizuar Vendimi Përfundimtar i Inspektimit
- 30 raste janë lënë në fuqi Vendimet Përfundimtare të Inspektimit

Rezulton se nga rastet e ankimuar në Komisionin e Ankimit të gjobave, 77% e tyre kanë lënë në fuqi vendimarrjen e inspektorëve të punës në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit.

Krahasuar me një vit më parë kemi rritje të vendimeve të këtij komisioni që lënë në fuqi Vendimet Përfundimtare, pasi për vitin 2020 kjo shifër ishte në 60%.

Për vitin 2020 rezulton se 64 % e gjobave të vendosura nga inspektorët e punës janë ankimuar, ndërsa për vitin 2021 janë ankimuar 36% e gjobave të vendosura.

Ndjekja e Çështjeve Ligjore

Procese Gjyqësore të ndjekura

Sektori i Çështjeve Ligjore gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 ka ndjekur 32 procese gjyqësore, të cilat kanë të bëjnë me sanksionet e vendosura nga inspektimet e kryera në subjekte të ndryshme si dhe procese gjyqësore me objekt marrëdhëniet e punës, apo arsye të tjera ku institucioni ka qenë i thirrur në gjykim si palë e tretë.

Të gjitha këto procese gjyqësore janë të iniciuara me kërkesë të palëve të tjera dhe ISHPSHSH në të gjitha rastet është palë e paditur.

➤ Statusi i këtyre proceseve dhe i ecuresë së tyre rezulton si më poshtë:

Nga këto procese gjyqësore rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

32 procese gjyqësore, ku nga këto:

- Në 19 raste gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, që do të thotë që ISHPSHSH është palë fituese (12 raste me objekt Vendim Përfundimtar ndaj subjekteve, 1 rast me objekt marrëdhënie pune, 6 raste ku ISHPSHSH është palë palë e tretë).
- Në 6 raste gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë që do të thotë që ISHPSHSH ka humbur procesin (4 raste me objekt Vendimin Përfundimtar ndaj subjekteve, 2 raste me objekt marrëdhënie pune).
- 7 raste vazhdojnë në gjykim në shkallë të parë, për të cilat nuk ka ende një vendim gjykate.

Analizë e të dhënave të proceseve gjyqësore:


- Në të gjitha proceset gjyqësore ku ISHPSHSH është palë ndërgjyqëse, në 76 % të rasteve Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë , që do të thotë ISHPSHSH rezulton si palë fituese e procesit.
- 14.7 % e subjekteve kanë paraqitur ankim në gjykatë, pas vendimarrjes së Komisionit të Ankimit të Gjobave.
- Për këto raste, për 60 % të këtyre proceseve gjyqësore Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë dhe lënien në fuqi të gjobës.

Arritjet për proceset gjyqësore

Krahasimisht me një vit më parë rezulton se:

- Marrja pjesë në më shumë procese gjyqësore gjatë vitit 2021, ngarkesë e cila është arritur të menaxhohet me kujdesin e duhur.
- Rritja e rasteve të proceseve gjyqësore të fituara nga ISHPSHSH.

Në vitin 2020 ishin 70% e rasteve të fituara, në vitin 2021 janë 76% e gjyqeve të fituara.



- Në këtë rezultat kanë ndikimin e tyre një sërë faktorësh si:
 - Rritja e cilësisë së procesit të inspektimit si një proces i rregullt ligjor, i konstatuar i tillë edhe nga gjykata.
 - Provueshmeria me prova dhe fakte të gjetjeve të konstatuara gjatë inspektimit.

- Ndjekia me jurist apo me një përfaqësues nga ISHPSHSH në cdo proces gjyqësor, duke mos lënë gjykim në mungesë.
- Ndjekia me profesionalizëm e procesve gjyqësore.
- Asistenca juridike e Drejtorive Rajoanle në rastet kur kanë qenë palë ndërgjyqëse.

Qëndrimi i ISHPSHSH-së mbi zbatueshmërinë e dispozita të caktuara të legjislacionit të punës:

- Unifikimi e qëndrimit të ISHPSHSH-së mbi ***nenin 129 të Kodit të Punës në rast te refuzimit për të dhënë punë***, për arsye që nuk lidhen me punëmarrësin.
- Arsyetim dhe unifikim i aplikimit të nenit ***të 70 të Kodit të Punes në lidhje me vënien në dispozicion të punëmarrësve të "vendit te posacem te ngrënies"*** dhe te ***VKM-se nr.68/2018 "Për kufinjte dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pages së përfitua në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore"*** e cila citon detyrimin e punëdhënësit për sigurimin e "lokali për ngrënie" dhe kompensimin me page në natyrë për shpenzimet që bën punëmarrësi për ushqim.
- Me qëllim zbatimin e unifikuar te ***nenit 93 të Kodit të Punës*** së Republikës së Shqipërisë, I është dërguar Drejtorive Rajoanle qëndrimi që mban ISHPSHSH ***për pushimet vjetore***.
- Unifikim i zbatimit të dispozitës ***36 dhe 95 të Kodit të Punës mbi regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij***, nëse ky regjister duhet të mbahet detyrimisht në format fizik apo është i pranueshëm edhe elektronikisht.
- Unifikim mbi aplikimin e nenit ***nenit 92 te Kodit të Punës***.ne lidhje me zbatimin e te ***drejtës së punëmarrëses për leje vjetore, pasi është kthyer nga leja e lindjes***.
- Unifikimin mbi aplikimin e ***Neni 86, Kodi i Punës mbi "Ditët e festave zyrtare"***

Përmirësime të mëtejshme të aspektit ligjor

Ndjekja e ecurisë së ekzekutimit te gjobave duke udhëzuar rast pas rasti hapat që duhen të ndërmerren sipas specifikave.

Sistemuam ndjekien e ekzekutimit të gjobave, nëpërmjet disa hapave kyc për këtë proces, nisur nga monitorimi dhe asistenca juridike që konsiston në:

- ***U hartua Urdhëri nr.311, date 09.09.2021 i Kryeinspektorit***, për ndjekjen e ekzekutimit të Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit me gjobë, ***me qëllim që te kemi një gjurmin*** të qartë të gjobës që nga momenti i vendosjes së saj nga inspektorët e punës deri në arkëtim.
- ***Vënies në vëmendje të*** Drejtorive Rajonale të ISHPSHSH-së se zbatimi i ligjit në fazën e ekzekutimit, si faza e fundit e procedurës civile dhe administrative ndikon direkt në të drejtat e palëve dhe zbatimi i tyre është realizimi përfundimtar i të drejtave ligjore. Theksuam se mos ndjekia

e procedurave të vënies në ekzekutim të aktit administrativ nga nëpunësi përgjegjës, përbën shkak për fillimin e procedurave të largimit nga detyra.

- Nisur nga rëndësia e ekzekutimit të gjobave të cilët janë bërë tituj ekzekutive dhe ekzekutimi i tyre brenda një afati të arsyeshëm është i garantuar me ligj, **hartuam një marrëveshje tip, për rastet kur nga subjektet paraqitet kërkesë për marrëveshje për pagesë me këste**, duke e unifikuar këtë praktikë për rastet kur gjen zbatim.
- **Hartuam një udhëzues** mbi ekzekutimin e gjobave që ka disa risi dhe që ndikojnë në moszvarritjen e këtij procesi dhe krijimit të një fryme bashkëpunimi me subjektet konkretisht:
 - **Ankimimi në gjykatë ndaj vendimit të KAGJ-së nuk pezullon fillimin e procedurave të ekzekutimit të gjobës** që është shëndërruar në titull ekzekutiv.
 - **Dërgimi i një shkresë drejtuar subjektit për të likuajduar vullnetarisht detyrimin** brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të Inspektimit që është shëndërruar në titull ekzekutiv (duke i treguar fasilitetet se ku dhe kur duhet paguar) pasi nxit kështu ekzekutimin vullnetar dhe krijimin e një fryme bashkëpunimi me subjektin.
 - **I dhamë rol aktiv KAGJ-së, e cila me iniciativë të saj, të lëshojë rast pas rasti vërtetim që subjekti nuk ka ankimuar** vendimin të Inspektimit me gjobë, duke e ndihmuar këtë proces për vijimin e procedurave të ekzekutimit.
 - **Rregulluam rastet e njoftimit të subjekteve mbi vendimet përfundimtare të inspektimit kur nuk i gjendej adresa dhe njoftimi nuk ishte i mundur**, pasi vetëm kështu detyrimi bëhet i kërkuarshëm dhe shëndërrohet në titull ekzekutiv.

Në këtë Udhëzues janë parashikuar rastet se si duhet operuar duke kryer veprimet konkrete të përcaktuara në ligj, afatet procedurale të ekzekutimit, duke shmangur zvarritjet në ekzekutim, si dhe duke siguruar zbatueshmëri të njëjtë të titujve ekzekutiv.

- **Unifikuam kërkesën drejtuar Gjykatës për "Leshimin e urdherit të ekzekutimit"**, si dhe dokumentacionin shoqërues, të domosdoshëm për të provuar që jemi para një titulli ekzekutiv.
- Me qëllim nxitjen e subjektit të sanksionuar me gjobë, që të zbatojë aktin administrativ, **Drejtoritë Rajonale janë udhëzuar në dërgimin e njoftimit për ekzekutim vullnetar të gjobës, duke unifikuar edhe formate standarte të këtij njoftimi** :

Format 1: Kur ka paraqitur ankim në Komisionin e Ankimit të Gjobave pranë ISHPSHSH-së.

Format 2: Kur nuk ka paraqitur ankim në Komisionin e Ankimit të Gjobave, pranë ISHPSHSH-së.

- **Publikuam vendimet e inspektimit në faqen e ëeb** të ISHPSHSH, si formë e njoftimit publik e cila do të përdoret vetëm në rastet kur format e tjera të njoftimit nuk janë të mundura. I shërben sidomos fazës së ekzekutimit të gjobave.
- **Kryem një auditim të brendshëm** të ndjekjes së ecurisë së ekzekutimit të gjobave në cdo Rajon, me qëllim mosarritjen e këtij procesi dhe përmirësimin e tij.

Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore,

pranë ISHPSHSH, është një strukturë shtojcë, që i është bashkëngjitur Inspektoriatit të Punës që nga viti 2012. Kjo Drejtori ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ajo ka përgjegjësi ligjore dhe kompetenca të plota për inspektimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në rang kombëtar. Struktura aktuale e saj përbëhet nga 5 punonjës, (1 Drejtor dhe 4 Inspektorë).

I. Kuadri ligjor dhe strategjik që drejton prioritetet dhe objektivat e punës.

1. Ligji Nr.121/2016 datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i cili qartazi përfaqëson:

- Forcimin e strukturës inspektuese të kujdesit shoqëror, duke e ngritur atë në nivelin e një strukture më vete në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
- Forcimin e pushtetit lokal dhe sigurimin e pavarësisë së tij në administrimin e komuniteteve të tyre në nevojë, të tilla si përgatitja e planit social, sigurimi i buxhetit për shërbimet e reja shoqërore, bazuar në nevojat e komunitetit, dhe ndihmën ekonomike.
- Zgjerimin e tipologjive të shërbimeve të kujdesit shoqëror, pra të gjitha shërbimet e reja komunitare që shoqërojnë përfituesit, jo vetëm nëpër qendra përkujdesi shoqëror, por në rrugë, në familje e kudo, (*shërbimi emergjencës, shërbimi në familje, shërbimi parashoqëror, shërbimet on-line, etj.*).

Struktura aktuale e Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore përbëhet nga 5 punonjës, (1 Drejtor dhe 4 Inspektorë). Si një strukturë “terreni”, e vetmja e tillë, pra trupë inspektuese e subjekteve, të cilët ofrojnë shërbime të kujdesit social, përballet me pamundësinë e planifikimit dhe mbulimit me inspektim rutinë, të gjithë subjekteve në fjalë. Kështu, Drejtoria mund të targetojë/planifikojë deri në 120 subjekte për inspektim, që sëbashku me një trend vjetor prej 10-15 subjektësh, të cilat inspektohen për procedurë liçensimi apo trajtim ankesash, përbëjnë 29.5% të subjekteve të cilat ligji ia ngakon si detyrim për t’i inspektuar.

Në zbatim të masave të urdhëruara nga MSHMS, (Urdhëri Nr. 157, datë 10.03.2020), edhe përgjatë vitit 2021, shërbimet e përkujdesit shoqëror rezidencial ofrohet në kushtet e izolimit, të kufizimit numerik të grupeve përfituese dhe me paketë mbështetjeje në distancë, për shkak të aplikimit dhe riaplikimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së infektimit nga virusi Covid-19. Në këto kushte, inspektimi i qendrave të përkujdesit shoqëror u kombinua edhe me vlerësimin dhe monitorimin situatës së përgjithshme të përkujdesit të ofruar, nëpërmjet intervistave on-line, me drejtuesit/punonjësit social të qendrave të përkujdesit.

1. Treguesit numerikë të realizimit të programit të punës për vitin 2021.

Nr.	Aktiviteti	Plan	Fakt	Mosrealizimi	
				Nr.	Arsyeja
1	Tryeza Teknike, Ëorkshop në nivel kombëtar për forcimin dhe promovimin e rolit të inspektoriatit të kujdesit shoqëror.	x	8		
2	Takime vlerësuese në Bashki	48	51		
3	Qendra të reja të identifikuar e vlerësuara	x	32		
4	Vlerësime dhe inspektime të qendrave të përkujdesit shoqëror.	50	51		
5	Trajtim ankesash dhe kërkesa për informacion.	x	9		
6	Procedura liçensimi.	x	4		
Inspektime gjithësej (3+4+5+6)			96		
7	Intervista on-line për monitorimin e qendrave të përkujdesit shoqëror, përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19.	x	94		

II. Analiza e realizimit të objektivave dhe planit për vitin 2021.

1. Forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore.

Në bashkëpunim me UNICEF, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, si një nga aktorët kryesorë të reformës së shërbimeve shoqërore, është përfshirë në dhënien e ekspertizës dhe promovimin e inspektimit të shërbimeve sociale në:

- **1** Workshop në nivel kombëtar, në të cilin, u prezantua raportin: “Roli i Inspektoratit të Shërbimit Shoqëror dhe analiza strukturore e Bashkive, në përmbushje të përgjegjësi që burojnë nga Ligji 121 datë 24.11.2016”.

Në nivelin e 87% të Bashkive, të vlerësuara, në rang vendi, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, vlerëson se është e domosdoshme që vlerësimi dhe rivlerësimi i tyre të vazhdojë, sikurse edhe nevoja për mbështetjen e tyre me ekspertë dhe trajnime për të riorganizuar strukturat, për të bërë funksionale Planet Sociale, mekanizmat dhe shërbimet e krijuara.

Përfaqësues të bashkive dhe shoqërisë civile vlerësuan raportin, punën e Inspektoratit dhe kërkuar që ky bashkëbisedim të vazhdojë. Mbatja e një dialogu të rregullt midis nivelit qendror dhe vendor është i domosdoshëm, për të forcuar kapacitetet dhe për të rritur investimet për shërbimet e përkujdesit social.

- **1** Tryezë Teknike, për të iniciuar dhe programuar përmirësime dhe plotësime të legjislacionit me akte nënligjore, për rolin dhe forcimin e Inspektoriatit të Kujdesit Shoqëror, me MSHMS, Unicef, UNDP.
- **5** tryeza teknike që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, zhvillimin e politikave sociale, (*grupe pune ndërministrrore, IMPG*).
- **1** Tryezë Teknike, për diskutimin dhe dakortësimin e plani aktiviteteve për vitin 2022, me UNICEF dhe UNDP, sipas programeve të secilës agjensi, në kuadër të Programit 4 vjeçar “Leave No One Behind” LNB2. Qëllimi i bashkëpunimit, bazuar në planin e aktiviteteve për vitin e parë, (2022) është fuqizimi i trupës së inspektimit të kujdesit shoqëror.

2. Takime informuese dhe vlerësuese në Drejtoritë e Përkujdesit Shoqëror në të gjithë vendin.

Qëllimi dhe objektivat e takimeve me strukturat përgjegjëse të përkujdesit social në bashki.

- Marrja e informacionit, mbi zhvillimet në drejtim të organizimit të strukturës përgjegjëse të përkujdesit shoqëror, (Ligji Nr.121/2016 datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM Nr.518, datë 04.09.2018).
- Marrja e informacionit për Planin e Kujdesit Social të Bashkisë, (Ligji Nr.121/2016).
- Identifikimi, njohja dhe vlerësimi i shërbimeve të reja, të krijuara nga Bashkitë dhe aktorët e tjerë në territorin e tyre.
- Masat e marra për parandalimin e infektimit nga COVID-19 dhe si janë zbatuar.

Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, në përputhje me planet mujore, ka realizuar **51 takime vlerësuese** me strukturat përgjegjëse të kujdesit social, (drejtoritë/sectorë/zyra), në **1 Qark, 38 Bashki dhe 13 Njësi Administrative** në përbërje të tyre.

Në tabelën më poshtë prezantohen numerikisht konstatimet lidhur me zhvillimet strukturore, planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të reja nga ana e bashkive².

Nr.	Treguesi i vlerësuar	Vlerësuar 2021	Nga fillimi i procesit
1	Bashki të informuara dhe vlerësuar	38	58
2	Nr. Bashkive të konstatuar me Plan Social të miratuar	37	51
3	Nr. Bashkive të konstatuar me Plan Social në proces miratimi	1	5
4	Nr. Bashkive që nuk kanë hartuar Planin Social Vendor	0	2
5	Nr. Bashkive të konstatuar me struktura të plotësuar (sipas VKM Nr.518)	13	25
6	Nr. Bashkive të konstatuar me struktura të plotësuar pjesërisht	16	19
7	Nr. Bashkive të konstatuar me mungesë të strukturës përgjegjëse	9	14
8	Nr. shërbimeve të reja të krijuara nga vetë Bashkitë apo në partneritet	32	64
9	Nr. i Bashkive pa asnjë Shërbim Kujdesit Social	13	16

Një nga objektivat e Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore për vlerësim të strukturave përgjegjëse të kujdesit social në bashki është edhe përditësimi i bazës së të dhënave, apo hartëzimi i bashkive dhe shërbimeve të reja të krijuara.

Baza e të dhënave, (për bashkitë), përmban informacione për numrin e popullsisë, rreth strukturës përgjegjëse, stafit, detyrave, punonjësve me detyra apo role të mbivendosura, për planet sociale vendore, grupet në nevojë, projektet dhe kontaktet. Pjesë përbërëse e kësaj Baze të dhënash është edhe hartëzimi i Qendrave/Njësisve të shërbimit, me informacione rreth administruesit, modelit të shërbimit, standarteve/VKM përkatëse, rreth përfituesve, paketës së shërbimit dhe kontaktet e nevojshme. Kjo baza të dhënash është një instrument i rëndësishëm në punën përgatitore të inspektimit, (faza e parë e procesit të inspektimit), si edhe instrument për analizë dhe për përcaktim të riskut dhe të prioriteteve të inspektimit.

Në përfundim të vlerësimit të çdo bashkie, si edhe në një Raport përmbledhës, janë bërë prezent konstatimet dhe rekomandimet e dhëna MSHMS, MFE, Agjensive të ndryshme ndërkombëtare me të cilat

² Njësitë Administrative nuk janë pasqyruar numër më vete në tabelë pasi kanë një filtër klasifikimi më të komplikuar, bazuar në përcaktimin e Ligjit 121/2016 në referim të numrin e popullsisë, e për pasojë pasqyrimi në tabelë ka nevojë për më shumë tregues dhe kombinacione.

është duke bashkëpunuar Drejtoria, si edhe çdo titullari të Bashkisë dhe Strukturës përgjegjëse të Kujdesit Social.

3. Inspektimi i qendrave të përkujdesit shoqëror për vitin 2021.

Për vitin 2021 Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, bazuar në Standartet e Shërbimeve Shoqërore ka vlerësuar situatën e përgjithshme të cilësisë së shërbimit dhe të plotësimit të treguesve të standarteve, drejtëpërdrejtë në **96 qendra të përkujdesit shoqëror**, të grupuara si më poshtë:

- **51** inspektime tematike të planifikuara;
- **32** identifikime dhe vlerësime të shërbime të reja;
- **13** shërbime për arsye të verifikimit të ankesave dhe të procedurës së së liçensimit.

Referuar tipologjisë së përkujdesit, vlerësimin e situatës së përgjithshme të përkujdesit, bazuar në Standartet e Shërbimeve Shoqërore u realizuan në:

- **30** qendra, publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë **përkujdes rezidencial**;
- **66** qendra, publike dhe jopublike, **të përkujdesit komunitar**, përfshirë këtu, qendra ditore, qendra terapeutike, shërbime në familje, shërbime multidisiplinare, shërbime emergjente.

Specifikisht, nga 96 qendrat e inspektuara, 26 prej tyre janë shërbime, të cilat kanë përfutur Fond Social nga MSHMS për vitin 2020. Në objektin e kontrollit u përfshi edhe zbatimi i kërkesave të VKM Nr.150, datë 20.03.2019, “Për Metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit social”, që do të thotë, që përveç kryerjes së procedurës standart të kontrollit në qendrën e përkujdesit, gjatë inspektimit u realizua edhe kontrolli i dokumentacionit të aplikimit për Fondin Social, Planet Sociale Vendore, evidenca, raporte, akt-marrëveshje, vendime të Këshillit Bashkiak apo të Këshillit të Qarkut përkatës, përfshirë dokumentacionin për partneritetin dhe procedurat me Organizatat përfituese të Fondit Social, në 14 bashki dhe 4 Këshilla Qarku.

Në 5 raste u konstatua mosfunksionim i shërbimit, (19.2%), dhe 17 raste, 65.4%), u konstatua nevoja për përmirësimin e treguesve/indikatorëve të standarteve të përkujdesit. Konstatimet dhe rekomandimet e dhëna nga Inspektoriati, u bënë pjesë e analizës së MSHMS-së mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023.

Nga inspektimet e kryera gjatë vitit 2021, (pra në 96 shërbime), përfshi këtu, inspektimet tematike të planifikuara dhe ato të paplanifikuara, për procedura trajtimi të ankesës apo liçensimit, u konstatua se, përgjithësisht, janë plotësuar kërkesat proceduriale dhe treguesit e standarteve.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë e konstatuara janë në tabelën në vijim:

Nr.	Çështja sipas standartit	Përshkrimi i mangësisë së konstatuar	Frekuenca	
			Nr.	në %
1	Liçensimi	Liçensimi për ofrimin e shërbimit të kujdesit shoqëror	4	4.2
2	Kushte fizike të strukturës	Amortizim, lagështirë, kushtet higjeno-sanitare	3	3.1
		Mungësë e aksesimi të strukturës	2	2.1
		Sistemi i mbrojtjes nga zjarri, shkaqe të tjera, (sistem alarmi)	1	1.1
3	Stafi i shërbimit	Mungësë e stafit, kryesisht mosplotësim i vendeve vakante	4	4.2

4	Sistemi i mbrojtjes dhe e Drejta Ankimimit	Mungesë e rinovimit të librezave shëndetësore	4	4.2
		Mos kryerja e vlerësimit vjetor të performancës	2	2.1
		Mangësi në procedurën e hapjes së Kutisë së Ankimimit	3	3.1
		Mangësi në dokumentimin e punës për hulumtimin e dyshimeve, ngjarjeve dhe incidenteve, (regjistri)	7	7.3

Sikurse lexohet nga tabela, mangësia më frekvente është mungesa e Regjistrimit të hulumtimeve. Kjo u konstatua më së shumti në Qendrat e përkujdesit komunitar. Në këto Qendra konstatohet që njihen dhe aplikohen, nga stafi, formatet e referimit dhe të denoncimit të rastit të dhunimit apo abuzimit të përfituesve, por rëndom këto janë praktika rast pas rasti, dhe kur është një incident i ndodhur. Ndërkohë që rreth çështjes së dhunës, abuzimit, neglizhimit të përfituesit ka më shumë punë dhe situatë hulumtuese, përfshirë këtu edhe sinjalizime apo dyshime të paprovuara, puna verifikuese, vlerësimi dhe konkluzioni “humbet”, nuk pasqyrohet, regjistrohet. Regjistrimi i çdo situatë dhe dyshimi vlerësohet i rëndësishëm edhe si forcim i sistemit të mbrojtjes së përfituesve nga dhuna dhe abuzimi.

Gjithashtu, edhe pse jo shumë frekvente, çështja e liçensimit sillet në vëmendje sepse është konstatuar, përgjithësisht në nivelin e Strukturave përgjegjëse të kujdesit social në bashki nuk kanë informacion për kërkesën dhe procedurat e liçensimit, konkretisht: Neni 27 i Ligjit Nr.121/2016, datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për liçensat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe rregullimet të tjera nënligjore të përbashkëta”, Udhëzimi Nr.2, datë 10.03.2014 “Për Procedurat e shqyrtimit të kërkesave për liçencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të përkujdesit shoqëror”, MMSR.

Rekomandimet e dhëna, për secilën qendër përkujdesi dhe për secilën çështje, janë të natyrës dokumentuese dhe plotësuese dhe kanë qëllim përmirësimin të cilësisë së shërbimit.

4. Intervista on-line për vlerësimin e përkujdesit dhe situatës së qendrave përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19.

Përgjatë vitit 2021, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, për shkak të aplikimit dhe riaplikimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së infektimit nga virusi Covid-19, ka realizuar **94** inspektime on-line të **qendrave publike dhe jopublike** të përkujdesit rezidencial dhe ditor për të moshuar, fëmijë dhe për PAK, me qëllim vlerësimin e situatës së përgjithshme të funksionimit të shërbimit të kujdesit shoqëror dhe të masave të marra për parandalimin e përhapjes së infektimit nga virusi Covid-19, sipas udhëzimeve, protokolleve dhe rekomandimeve të MSHMS-së.

Gjithashtu, verifikimi i masave të marra për parandalimin e përhapjes së infektimit nga virusi Covid-19, nga ana e Qendrave të përkujdesit, përgjatë këtij viti, ka qenë edhe pjesë e programit të inspektimit në vend, (në qendër). Përgjithësisht është konstatuar se përshtatja e shërbimit, (karantinimi, shërbimi me distancim, ulje të grupeve të përfituesve nëpërmjet frekuentimit me grafik, apo mbështetja në banesë), është në zbatim të protokollëve, urdhëresave të MSHMS-së, SHSSH, si dhe me rregullore të veçantë në qendrat përkatëse. Është konstatuar plotësimi ditor i regjistrimit të temperaturës, si për përfituesit ashtu edhe për stafin. Gjithashtu, në mjediset e shërbimit, është konstatuar prezenca e informacioneve, mjeteve mbrojtëse individuale, maska, solucione dizifektuese, etj.

5. Trajtimi Ankesave dhe kërkesave për Liçensim

Përgjatë vitit 2021 Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, ka realizuar brenda afatit të gjitha kërkesat e ardhura në adresë të saj, si ankesa apo kërkesa për liçensim. Për trajtimin e çështjeve të përfitimit të përkujdesit shoqëror dhe të plotësimit të standarteve të shërbimit shoqëror lidhur me ankesat dhe shqetësimet e ngritura, si edhe vlerësimi për procedurë liçensimi është kryer verifikimi në vend. Numerikisht rastet janë si më poshtë:

- 5 raste ankimimi, adresuar drejtëpërdrejtë ISHPSHSH-së nga të interesuar;
- 4 raste kërkesa për informacion për qendra përkujdesi, lidhur me shqetësimet për plotësimin e standarteve apo çështje të veçantë të tyre, adresuar nga Kuvendi i Shqipërisë, MSHMS, ASHMDF, SHSSH, Bashkia Tiranë.
- 4 raste për procedurë liçensimi.

Kërkesat dhe ankesat, për vitin 2021, nuk janë të deleguara nga Platforma e Bashkëqeverisjes, janë në kohë para hyrjes në fuqi të Ligjit të Bashkëqeverisjes, si edhe janë ndjekur të gjitha procedurat përkatëse të protokollimit dhe të trajtimit.

TRAJNIMET E REALIZUARA GJATE VITIT 2021

1. Janë trajnuar tek ASPA 20 (njëzet) inspektorë të cilët kanë plotësuar periudhën e kohës së provës dhe kanë kryer "Trajnimin e detyrueshëm për pranim në Shërbimin Civil", "Prezantimi me administratën publike", online.
 2. Është bërë ndjekja e Webinareve online nga nëpunësit e institucionit të zhvilluar nga Shkolla e Administratës Publike, 80 inspektorë.
 3. 2 (dy) nëpunës nga drejtoria qendrore kanë ndjekur trajnimin me temë "Për parandalimin dhe adresimin e dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës në institucionet e administratës shtetërore"
- "Teknologjia për mbështetjen e punës në distancë" datë 22 mars-7 prill 2021
 - "Programet e shkëmbimit të Ambasades Amerikane" date 11 maj 2021
 - "Reforma territoriale, decentralizimi dhe veteqeverisja vendore" datë 11 maj 2021
 - "Shkelje e sigurisë për informacionin e klasifikuar dhe sistemin e raportimit" date 29 prill 2021
 - "Veteqeverisja vendore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara" datë 28 prill 2021
 - "Metodologjia e vlerësimit të projekteve madhore për financim nga BE " date 27 prill 2021
 - "Rendësia e fazës së formulimit të strategjive në monitorimin e tyre" datë 16 prill 2021
 - "Ligjshmëria e përpunimit të dhënave personale" datë 29 mars 2021
 - "Elementet e një procedimi disiplinor" datë 26 mars 2021
 - "Dallimi mes emocioneve dhe inteligjencës emocionale" datë 16 shkurt 2021
 - "Siguria Kibernetike në Shqipëri" datë 18 janar 2021
 - "Siguria Kibernetike në Shqipëri" date 6 janar 2021

Departamenti i Financës

Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit por edhe në respekt të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr.22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore” si dhe në zbatim të udhëzimit nr.4, datë 25.01.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2021”, në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për **12-mujorin e vitit 2021** për Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore .

Në tabelën në vijim ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur të dhënat mbi buxhetin e miratuar dhe realizimin e tyre sipas artikujve.

			12/ MUJORI Viti 2021 (000)		
Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor Plani	Plani 1- mujor/progresiv	Realizimi Fakti 12-mujor progresiv	% e Realizimit
600+601	Paga Sigurime	130.476	130.475	125.137	0.96
602	Mallra Shërbime	30.588	31.795	27.681	0.87
231	Investime	10.000	10.000	9.217	0.92
606	Fondi i vecantë	1.236		1.054	0.85
6		500			
	TOTALI	172.800	172.270	163.089	3.6

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike. Burimi kryesor i të ardhurave të institucionit tonë janë gjjobat dhe kamatvonesat nga gjjobat.

Të ardhurat në total nga gjjobat dhe kamat vonesat e gjjobave gjatë vitit 2021 jane si më poshtë:

Kodi i Institucionit	Llogaria	Përshkrimi	Vlera në Lekë
1010227	7115499	Arkëtime nga gjjobat	19,481,820
1010227	7115500	Arkëtime nga Kamat vonesat e gjjobave	2,812,356
		Totali	22,294,176

Gjatë vitit 2021 Inspektorati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore ka realizuar edhe rikonstruksionin e godinës gjë e cila ka sjellë përmirësim të imazhit të ISHPSHSH-së.

Investimi është realizuar në vlera të paraqitura në tabelën si më poshtë:

<u>Kodi i Institucionit</u>	<u>Llogaria</u>	<u>Përshkrimi</u>	<u>Vlera në Lekë</u>
<u>1010227</u>	<u>230</u>	<u>Projekt preventivi</u>	<u>219.929</u>
<u>1010227</u>	<u>231</u>	<u>Rikonstruksioni</u>	<u>8.997</u>
		<u>Totali</u>	<u>9.217</u>

Në dhjetor 2021 ISHPSHSH ka arritur një marrëveshje të suksesshme bashkëpunimi me **Credins Bank** e cila dhuroi për institucionin tonë **5 kompjutera me vlerë 592,500 lekë** (Pesëqind e nentëdhjetë e dy mijë e pesëqind lekë) të cilët janë shumë të dobishëm në ecurinë e punës tonë të përditëshme.

DISA PROBLEMATIKA

- Struktura aktuale ka 14 % (22) të vendeve të punës vakante
- Strukturat rajonale nuk kanë mjaftueshëm administratë mbështetëse.
- Pajisjet e punës (tablet dhe laptop) nuk janë të mjaftueshme për të siguruar një proces inspektimi normal.
- Sistemi “e-inspektimi”, ka nevojë për përmirësim në akses, pasi aktualisht është pothuajse e pamundur të bësh analiza pune mbi të dhënat që ka ky system. (Në dy modulet planifikim dhe inspektim)
- Bashkëpunimi me DPT ka nevojë për përmirësim, për të patur të dhënat e deklaruara si listë subjektesh, për të përmirësuar procesin e planifikimit të inspektimit.
- Logjistika aktuale (automjete) nuk përmbush plotësimin e nevojave të stafit për zhvillimin e një procesi inspektimi cilësor, siç kërkohet.
- Nevoja për rishikim të Listë-Verifikimeve aktuale të inspektimit, kërkon mundësisht dhe një asistence teknike.
- Nevoja për rivlerësim të pagës së inspektorëve në raport me vështirësinë e punës që kryejnë.

AKTIVITETE



Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

30 marzo · 🌐

...

✅ U zhvillua "Takimi Rajonal për rritjen e qasjes së Grave në punësim" i organizuar nga qendra "D4D" të Kosovës dhe Qendrës "Aleanca Gjimore për Zhvillim të Shqipërisë", me pjesëmarrës të Institucioneve Qeveritare, Shoqërisë Civile dhe aktorëve të tjerë të interesuar të të dy palëve. Në fjalën e tij Z.Ardit Kaja theksoi rëndësinë e Grave si një forcë madhore për zhvillimin dhe integrimin e shoqërisë.



Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

7 ottobre alle ore 11:28 · 🌐

...

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale VLORE në kuadër të fushatës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2020-2022 e udhëhequr nga Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (EU-OSHA), nën sloganin "Vende Pune të shëndetshme, Lehtëso Ngarkesën" po shpërndan fletë-palosje, postera, udhëzues e fletushka të përgatitura nga kjo Agjenci, si dhe po organizon vizita në subjekte të ndryshme me synim informimin.



OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS

Vazhdimin e punës dhe zhvillimi më tej i platformës „Platforma Ndërgjegjësuere“, e aksesueshme dhe nga punëdhënës e punëmarrës në drejtim të marrjes së informacionit bazë mbi detyrimet e legjislacionit të punës.

Ky ndërgjegjësim do të shërbejë në:

- Ndërhyrjen në kohë të inspektorit të punës si rregullator në krijimin e një **marrëdhënie të shëndoshë punësimi** për të ulur rastet e ankesave mbas ndërprerjes së një marrëdhënie pune, të destinuara të përfundojnë në gjykatë dhe shpesh herë dhe jo me zgjidhje për palët e dëmtuara.
- Marrjen e masave në kohën e duhur për **zhvillimin e punës në kushte të sigurta**, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e aksidenteve në punë.
- Njoftimin dhe **trajtimin në kohë të rasteve të aksidenteve**, duke ndjekur linjën ligjore e duke ndikuar në përfitimet e punëmarrësve të aksidentuar për shkak të punës.
- Rritjen e efektivitetit të inspektimit nëpërmjet **koordinimit e planifikimit të inspektimeve mbi bazë risku** për inspektime në aktivitete : të një **shkallë të lartë rrezikshmërie**; me **numër të konsiderueshëm punëmarrësish**; me **raste të përsëritura të ankesave apo aksidenteve**, për **zgjerimin e hartës** dhe mbulimit me inspektim të të gjithë teritorit të RSH, duke futur dhe konceptin e “Inspektimeve smart”, matjen e efektivitetit të një inspektimi nëpërmjet monitorimit dhe **mbikqyrjes së inspektimeve online në kohë reale në raport me cilësinë e vendimarrjes**.
- **Shkëmbimit të të dhënave vlerësuese të kryqëzuara** me institucionet e tjera kontrolluese.
- **Adresim të problematikave** në lidhje me zbatueshmërinë e Legjislacionit të Punës dhe indicien e ndryshimeve ligjore të diktuar në kohë.
- Fokusim për kontrollin cilësor të informalitetit gri.